



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 01/49

Datë: 29.05.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 maj 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Urdhërohen të gjithë ministrat e Qeverisë së Republikës së Kosovës, që në rast të udhëtimit zyrtar jashtë vendit, të njoftojnë paraprakisht Kryeministrin, para realizimit të udhëtimit në pajtim me dispozitat e Rregullores 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive dhe Udhëzimit Administrativ nr. MSHP 2004/07 për udhëtimet zyrtare;
2. Njoftimi duhet të përmbajë: qëllimin e udhëtimit, destinacionin, numrin e stafit shoqërues dhe informata shtesë;
3. Obligohen Ministrat që pas udhëtimit brenda pesë (5) ditëve të raportojnë me shkrim dhe gojarisht në mbledhje të qeverisë për rezultatet e udhëtimit;
4. Obligohen Ministrat që të mbajnë evidencë për udhëtimet e stafit dhe vartësve të tyre dhe të dorëzojnë raport për këto udhëtime çdo tre (3) muaj;
5. Për veprimet që bien ndesh me këtë Vendim në lidhje me udhëtimet zyrtare të ministrave, do të ndërmerren masat përkatëse komform legjislacionit në fuqi;
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Të i u dërgohet:**

- Të gjithë Zëvendëskryeministrave;
- Të gjithë Ministrave;
- Të gjithë shefave të Kabineteve të Ministrave;
- Të gjithë Sekretarëve të Përgjithshëm të ministrive;
- Arkivit të ZKM-së.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/49

Datë: 29.05.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 maj 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e Unionit "Konkurrenca e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (COSME) 2014-2020".
2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 03/49


Datë: 29.05.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 maj 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Z. Mendim Rugova, emërohet Koordinator Nacional për Ndryshime Klimatike dhe Çështje të Ambientit.
2. I emëruari nga pika 1 e këtij vendimi kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara si më poshtë:
  - 2.1. Koordinon dhe bashkëpunon me institucionet relevante çështjet klimatike dhe të ambientit në Kosovë.
  - 2.2. Asiston, bashkëpunon dhe koordinon me institucionet relevante vendore çështjet e anëtarësimit të Kosovës në organizmat rajonal dhe ndërkombëtarë për çështjet klimatike dhe të ambientit.
  - 2.3. Mbledh të dhëna meteorologjike, të ujit, të dheut dhe ajrit, me qëllim të përpunimit dhe analizimit të tyre.
  - 2.4. Asiston në ngritjen dhe avancimin e kapaciteteve si profesionale ashtu edhe teknike në institucionet relevante që janë përgjegjëse për matjen, mbledhjen, analizimin dhe raportimin e të dhënave meteorologjike, të ujit, të dheut dhe ajrit.
  - 2.5. Merr pjesë aktive në takime, seminare, punëtori dhe konferenca vendore dhe ndërkombëtare nga fushat që përfshijnë klimën dhe ambientin.
  - 2.6. Organizon dhe asiston në mënyrë aktive në takime të nivelit vendor dhe ndërkombëtar, si dhe merr pjesë në seminare, punëtori dhe konferenca me qëllim të paraqitjes së gjendjes reale në Kosovë, rajon dhe gjetiu, duke informuar në kohë dhe paralajmëruar për gjendjen aktuale dhe parashikimin për të ardhmen.

- 2.7. I raporton Kryeministrin për ecurinë e procesit dhe sipas nevojës i raporton qeverisë, duke ofruar informacion dhe analiza mbi dinamikat dhe progresin në këto fusha.
3. Mandati i të emëruarit nga pika 1. e këtij vendimi zgjatë deri në një vendim tjetër të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
  4. I emëruari nga pika 1. e këtij vendimi ka të drejtë në emërimin e tre (3) këshilltarëve dhe një (1) asistenti për të ndihmuar në zbatimin e termave të referencës.
  5. Koordinatorin do të ketë pagën e barasvlershme me pagën e Ministrin.
  6. Këshilltarët e Koordinatorit do të kenë pagën e barasvlershme me pagën e këshilltarit të Ministrin.
  7. Paga e asistentit të Koordinatorit është e barasvlershme me pagën e asistenteve të Ministrin.
  8. Obligohet Zyra e Kryeministrin dhe Ministria e Financave për mbështetjen buxhetore dhe administrative të Koordinatorit Nacional për Ndryshime Klimatike dhe Çështje të Ambientit.
  9. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave;
- të gjitha ministrive (ministrave);
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës;
- Arkivit të Qeverisë.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

**Nr. 04/49**  
**Datë: 29.05.2018**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 maj 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Z. Rexhep Hoti emërohet Koordinator Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport në Republikën e Kosovës.
2. I emëruari nga pika 1. e këtij vendimi i kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara si më poshtë:
  - 2.1. Koordinon, mbështetë, analizon dhe ndihmon zhvillimin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Republikën e Kosovës.
  - 2.2. Ofron informacione, në efikasitetin e cilësisë në fushat përkatëse përmes stimulimit në organizimin e garave, kuizeve të ndryshme në të gjitha nivelet duke filluar nga niveli komunal e deri te niveli qendror;
  - 2.3. Bashkëpunon ngushtë me Institucionet si: Zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Asociacionin e Komunave të Kosovës, Shoqërinë Civile dhe Komunitetet.
  - 2.4. Mbështetë Institucionet relevante të fushave të sipër përmendura në zhvillimin dhe zbatimin e politikave përkatëse.
  - 2.5. Do të rris koordinimin ndërmjet nivelit qendror dhe atij lokal dhe rritjen e efikasitetit për aktivitetet në fushat përkatëse në funksion të konkurrencës dhe inovacionit.

- 2.6. Do të ofroj rekomandime dhe informata për Kryeministrin dhe institucionet tjera të interesit dhe partnerët tjerë në lidhje me dinamikën e realizimit të detyrave konkrete në përmirësimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm të fushave përkatëse.
- 2.7. Do të bashkëpunoj me faktorin ndërkombëtarë dhe njëkohësisht do të kërkojë nga ta të ndihmojnë në realizimin e projekteve të përbashkëta në Kulturë, Rini dhe Sport.
- 2.8. Koordinatori Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport i raporton Kryeministrin të Republikës së Kosovës.
3. Mandati i të emëruarit nga pika 1. e këtij vendimi zgjatë deri në një vendim tjetër të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
4. I emëruari nga pika 1. e këtij vendimi ka të drejtë në emërimin e tre (3) këshilltarëve dhe një (1) asistenti për të ndihmuar në zbatimin e termave të referencës.
5. Koordinatori do të ketë pagën e barasvlershme me pagën e Ministrit.
6. Këshilltarët e Koordinatorit do të kenë pagën e barasvlershme me pagën e këshilltarit të Ministrit.
7. Paga e asistentit të Koordinatorit është e barasvlershme me pagën e asistenteve të Ministrit.
8. Obligohet Zyra e Kryeministrin dhe Ministria e Financave për mbështetjen buxhetore dhe administrative të Koordinatorit Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport në Republikën e Kosovës.
9. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave;
- të gjitha ministrive (ministrave);
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës;
- Arkivit të Qeverisë.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 05/49

Datë: 29.05.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 6 të Ligjit nr. 05/L-120 për Trepçën (GZ/Nr.36/31 tetor 2016) duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 maj 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet propozimi i Bordit Mbikqyrës për Statutin e Shoqërisë Aksionare Trepça Sh.A.
2. Statuti i Shoqërisë Aksionare Trepça Sh.A nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 06/49

Datë: 29.05.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 maj 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Organizatës së Veteranëve të Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për ndarjen e mjete financiare në shumë prej 300.000 (treqind mijë) euro, për mbulimin e shpenzimeve të 1500 veteranëve për pushime verore në bregdetin e Shqipërisë.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi, ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara, nën programi Shpenzimet e Paparashikuara, me kod 13100, kategoria e Shpenzimeve të Rezervës dhe transferohen në Ministrinë e Financave, nën programi i Thesarit me kod 11200, kategoria e shpenzimeve subvencione dhe transfere. Këto mjete transferohen në xhirollogarinë e OVL të UÇK-së: NLB Prishtinë 170 100 1010 734491.
3. Obligohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 07/49

Datë: 29.05.2018


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 11, 39, 44 dhe nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr. 03/L-205, të nenit 53 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, duke shqyrtuar kërkesën e MMPH-së, me nr. prot. 2367-2, datë 08.05.2018, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 maj 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**Për anulimin, ndryshimin dhe plotësimin e pjesërishëm të Vendimit Përfundimtar  
Nr. 06/160 datë 11.12.2013**

1. Anulohen pjesërisht shpronësimet e miratuara me Vendimin Përfundimtar nr. 06/160, datë 11.12.2013, për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga ndërtimi i rrugës nacionale N2 Prishtinë - Mitrovicë, segmenti Gojbulë - Smrekovnicë Loti I, Zonat kadastrale: Bajskë, Gojbulë, Sllatinë (Gjelbërishtë) dhe Smrekovnicë të Komunës së Vushtrisë, sipas tabelave pjesë përbërëse të këtij vendimi, Aneksi I.
2. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga ndërtimi i rrugës nacionale N2 Prishtinë - Mitrovicë, segmenti Gojbulë - Smrekovnicë Loti I, Zonat kadastrale: Bajskë, Dobërllukë Gojbulë, Sllatinë (Gjelbërishtë) dhe Smrekovnicë të Komunës së Vushtrisë, sipas tabelave pjesë përbërëse të këtij vendimi, Aneksi II.
3. Mbeten në fuqi shpronësimet e miratuara me Vendimin Përfundimtar nr. 06/160 datë 11.12.2013 për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga ndërtimi i rrugës nacionale N2 Prishtinë - Mitrovicë, segmenti Gojbulë - Smrekovnicë Loti I, Zonat kadastrale: Bajskë, Dobërllukë Gojbulë, Sllatinë (Gjelbërishtë) dhe Smrekovnicë të Komunës së Vushtrisë, sipas tabelave pjesë përbërëse të këtij vendimi, Aneksi III.
4. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH, i dërgon vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij vendimi.

5. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
6. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit dhe tabelat pjesë përbërëse të këtij vendimi në të cilat është përcaktuar shumta e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve iu janë prekur nga procesi i shpronësimit.
7. Kundër këtij vendimi subjektet kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në gjykatën kompetente vetëm për kundërshtimin e shumës së kompensimit të përcaktuar në këtë vendim, subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat pjesë përbërëse të këtij vendimi.
8. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrën Ligjore të Organit përkatës Shpronësues. Nëse parashtruesi i ankesës nuk vepron në përputhje me këtë paragraf, gjykata e refuzon ankesën.
9. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit, Departamenti i Shpronësimit në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të përcaktuar në këtë vendim.
10. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

**Ramush HARADINAJ**  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 08/49  
Datë: 29.05.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4, 9, 10 dhe nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, duke shqyrtuar kërkesën e MMPH-së, me nr. prot. 2138-2, datë 16.05.2018, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 maj 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M P R E L I M I N A R**

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronës së paluajtshme nr. 871-1, Zona Kadastrale Krushë e Madhe, Komuna Rahovec, me qëllim të shëndrrimit të saj në Shtëpi Muze "Ukshin Hoti" për ruajtjen e vlerave historike të trashëgimisë kulturore të Kosovës, sipas tabelës të përshkruar nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarin e pronës së paluajtshme, pozitën e saj në kuadër të projektit të interesit publik si dhe sipërfaqes së saj, e cila tabelë është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit/MMPH që brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij vendimi preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej 10 ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës, si dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.
3. Kundër këtij vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky vendim.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (MMPH), Ministria e Financave dhe Komuna e Rahovecit.
5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

**Ramush HARADINAJ**  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 09/49  
Datë: 29.05.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4, 8, 44 dhe nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 maj 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejshëm i kërkesës për shpronësim të pronës së paluajtshme nr. 523-2 të ish Radiotelevizionit të Prishtinës (RTP), Zona Kadastrale Zabel i Ulët e cila është e nevojshme për realizimin e Projektit për ndërtimin e fushës së sportit "Stadiumi Sintetik" për nevoja të qytetarëve të Komunës së Drenasit, sipas tabelës të përshkruar nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik si dhe sipërfaqeve të tyre, e cila tabelë është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Ministria e Financave, konform Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ nr.02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përlllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (MMPH), Ministria e Financave dhe Komuna e Drenasit.
4. Kompensimi i pronave, shpenzimet e procedurës të shpronësimit dhe vlerësimit do të bëhen nga Komuna e Drenasit.
5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

**Ramush HARADINAJ**  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 10/49

Datë: 29.05.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 maj 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 107,600.00 euro, (njëqindeshtatë mijë e gjashtëqind euro) për mbulimin e shpenzimeve të shërimit të z. Etnik Balaj.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi, ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara, nën programi Shpenzimet e Paparashikuara, me kod 13100, kategoria e Shpenzimeve të Rezervës dhe transferohen në Ministrinë e Financave, nën programi i Thesarit me kod 11200, kategoria e shpenzimeve subvencione dhe transfere. Këto mjete transferohen në xhirollogarinë e Liv Hospital në Stamboll.
3. Obligohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 11/49  
Datë: 29.05.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 maj 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**për caktimin e lokacionit për „ndërtimin e objektit për ruajtjen e përkohshme të mbeturinave të rrezikshme”, në Kosovë**

1. Lejohet lokacioni për magazinimin e mbeturinave dhe materieve të rrezikshme në Komunën e Fushë Kosovës, Komuna Kadastrale Harilaq me parcelat kadastrale në pronësi të Agjencisë Pyjore të Kosovës, parcelat e nr. parcelat me ID të njësisë kadastrale P-72514003-00022-16; P-72514003-00022-17; P-72514003-00022-18; P-72514003-00022-19.
2. Obligohet Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 12/49  
Datë: 29.05.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 maj 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Të realizohet Plani Kombëtar për Zvogëlimin e Emisioneve (PKZE), 2018 - 2027.
2. Për realizimin e këtij plani, obligohen: Korporata Energjetike e Kosovës, Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor, si mbështetëse.
3. Ky plan ka për synim të zhvilloi dhe zbatoi instrumente të caktuara, për të ngritë cilësinë e jetës, duke siguruar bazën për përmirësim të cilësisë së ajrit. Të siguroj kornizën, me të cilën do të arrihet zvogëlimi i emetimeve në ajër nga Korporata Energjetike e Kosovës (TC Kosova A dhe TC Kosova B), që do të reflektoi në zvogëlimin e ndotjes së ajrit në rrethinën e KEK-ut po edhe në tërë territorin e Republikës së Kosovës, në pajtim me standardet e përcaktuara të BE dhe obligimeve që dalin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë.

Për arritjen e qëllimeve dhe objektivave të caktuara përmes masave të dala nga PKZE janë identifikuar veprimet, me realizimin e të cilave do të sigurohet:

- 3.1. Mbrojtja e mjedisit dhe shëndetit të popullatës;
- 3.2. Demonstrimi i angazhimit të Qeverisë, në mbrojtjen e cilësisë së ajrit;
- 3.3. Sigurimi i kornizës strategjike, për ndërmarjen e masave për një ajër të pastër, në të ardhmen, në bashkëpunim me partnerët lokal dhe ndërkombëtar, institucionet shkencore dhe shoqërisë civile;
- 3.4. Përpjekja e vazhdueshme për përmirësimin e gjendjes mjedisore, duke marrë parasysh performancën ekonomike dhe efikasitetin;

Përmirësimi i performacës së instalimeve të TC Kosova A dhe Kosova B, veçanërisht të Precipitatorëve Elektrostatik, do të ndikojë në zvogëlimin e ndotjes së ajrit në një anë po në anën tjetër mundësohet operimi i tyre edhe më tutje, si burim kryesor i prodhimit të energjisë elektrike në Republikën e Kosovës.

4. Institucionet nga pika 2. e këtij vendimi zbatojnë masat dhe detyrat e përcaktuara sipas këtij Plani, që del si obligim nga Vendimi 2013/05/MC-EnC i Këshillit të Ministrave të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, palë e të cilit është edhe Republika e Kosovës.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 13/49  
Datë: 29.05.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit nr. 06/L-020 për Buxhetin e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në zbatim të paragrafit 4 të nenit 2 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2018 për plotësimin dhe ndryshimin e Udhëzimit Administrativ nr. 05/2017 për Shkollimin Specialistik, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 maj 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Shëndetësisë për pagesën e specializantëve me vetëfinancim, nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere.
2. Obligohet Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave dhe institucionet tjera relevante të kryejnë të gjitha procedurat për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë